

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe ate komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, gjyqtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palëve ankuese;**

G. B., rr. ... R. e Serbisë, dhe

M. B., rr. ... R. e Serbisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson G. B.,

Kundër:

R. U., rr. "... , ...

Palë përgjegjëse,

Duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/135/2011, të datës 07 Dhjetor 2011, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave, me numër KPA00950, sipas kërkesës së ankuses G. B.), dhe ankesën e njëjtë kundër lëndëve të regjistruara në AKP sipas kërkesave të kërkuases tjetër O. V. me numër KPA41519, KPA41520, KPA41521, KPA41522, KPA41523, KPA41524, KPA41525, KPA41526, KPA41527 dhe KPA41528, të vendosura po ashtu me vendimin e njëjtë, nr. KKPC/D/A/135/2011, pas shqyrtimit në seancën e mbajtur me datë, 23 Shtator 2020, kolegji merr;

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga **G. B.** dhe **M. B.**, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/135/2011, të datës 07 Dhjetor 2011, e regjistruar në Gjykatën Supreme me numër GSK-KPA-A-001/2018, (që ka të bëjë me lëndën e regjistruar në AKP me numër KPA00950, të G. B.), dhe nga numri GSK-KPA-A-002/2018, deri në numër, GSK-KPA-010/2018, (që ka të bëjë me lëndët e regjistruara sipas kërkesave të paraqitura në AKP nga O. V. dhe ate KPA41519, KPA41520, KPA41521, KPA41522, KPA41523, KPA41524, KPA41525, KPA41526, KPA41527 dhe KPA41528), bashkohet në një lëndë të vetme, e cila mban numrin GSK-KPA-A-001/2018.
2. Pranohet si e bazuar ankesa e **G. B.**, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/135/2011, të datës 07 Dhjetor 2011, vetëm sa i përket kërkesës së saj me numër KPA00950.

3. Ndryshohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/135/2011, i datës 7 dhjetor 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA00950, në emër të ankueses G. B.ç dhe vendoset si vijon:
- a). Pranohet kërkesa e G. B. KPA00950, sepse e ka dëshmuar se është bashkëpronare me 1/6, pjesë ideale e pronës së pa luajtshme dhe ate e ngastrave kadastrale me numër ..., e parceluar deri në ..., të gjitha në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.78ha.45m², të cilat ndodhen në ...-..., të regjistruara në Fletën Poseduese me numër Ul-....
 - b). Pala ankuese ka të drejtë në ri-posedimin e ngastrave të tokës që përmenden më lartë, me 1/6 pjesë ideale të pronësisë”.
 - c). Çdo person tjetër që e ka uzurpuar pronën lëndore nën pikën a), duhet ta liroj atë brenda 30 ditë nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.
 - d). Nëse personi që e ka uzurpuar pronën lëndore nën pikën a), nuk e zbaton këtë aktgjykim në afatin e caktuar, do të dëbohet nga prona lëndore nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm.
4. Ankesa e paraqitur nga M. B., për mes të autorizuarës-ankueses G. B., hedhet poshtë si e pa lejuar, sepse pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën e zhvilluar në shkallën e parë, në Agjencinë Kosovare të Pronave, (Neni 10.2 i Ligjit nr.03/L-079).
5. Po ashtu Hedhet Poshtë si e pa lejuar, ankesa e G. B., kundër vendimit të njëjtë, lidhur me kërkesat e ushtruara në AKP, nga bashkëpronarja O. V., lëndët me numra KPA41519, KPA41520, KPA41521, KPA41522, KPA41523, KPA41524, KPA41525, KPA41526, KPA41527 dhe KPA41528, lëndët e regjistruara në Gjykatë Supreme me numër prej, GSK-KPA-A-002/2018, deri GSK-KPA-A-10.2018, sepse nuk ishte palë sipas këtyre kërkesave në AKP, e po ashtu lidhur me këto lëndë është vendosur meritorisht me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme nr. GSK-KPA-A-67/2014, të dt. 25 nëntor 2015, me të cilin janë aprovuar ankesat e ankueses O. V., ndërsa është ndryshuar Vendimi i KKPK-së, nr. KPCC/D/A/135/2011, i datës 07/12/2011.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Me datë 15 Qershor 2007 G. B., (tutje; pala ankuese), ka paraqitur tri kërkesa ligjërish të dyfishta për pronën e njëjtë, në Agjencinë Kosovare të Pronave (tutje AKP), në cilësinë e bartëses së të drejtës pronësore si bashkëpronare me 1/6 pjesë ideale, me të cilat kërkon ti regjistrohet e drejta pronësore në kadastër dhe ti kthehet posedimi i ngastrave kadastrale nr. ..., deri ..., të gjitha në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.78.45ha, me kulturë ara të klasës së tretë dhe rrugë, të cilat ndodhen në Prishtinë- lagja ..., të regjistruara sipas Fletës Poseduese nr. Ul-..., (tutje prona e kërkuar).

2. Pala ankuese në kërkesë kishte theksuar se, disponon dokumente pronësore valide të cilat mund të verifikohen në organe kompetente, gjer sa ndryshimet në regjistrat kadastral dhe bartja e pronës lëndore në personin e tretë ishte bërë mbi bazën e dokumenteve të pavlefshme,(të falsifikuara). Po ashtu thekson se sipas njohurive që ka në pronën lëndore, e cila është e uzurpuar, janë bërë ndërtime jo legale. Sipas palës ankuese ajo kishte humbur posedimin mbi këtë pronë më 1 Korrik 1999.
3. Në mbështetje të kërkesave në AKP *inter alia*, kishte dorëzuar dokumentet si në vijim;
 - Kopjen e Fletës Poseduese nr. ..., të datës 04.06.2001, sipas së cilës pronarë të ngastrave kadastrale prej numër ..., e gjer ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.78.45 ha, me kulturë arë e klasës së tretë dhe rrugë, e cila ndodhet në D.- ... janë; M. B. me 1/6 pjesë ideale, G. B. me 1/6 pjesë ideale, O. V. me 2/6, pjesë ideale dhe V. T. B., me 2/6 pjesë ideale.
 - Kopjen e letërnjoftimit të saj;
 - Kopjen e Planit nr. 8052, të datës 07 Qershor 2001, sipas së cilës M. B. me 1/6 pjesë ideale, G. B. me 1/6 pjesë ideale, O.V. me 2/6 pjesë ideale dhe V. T. B. me 2/6 pjesë ideale, janë bartës të drejtës pronësore të pronës së kërkuar;
 - Deklaratën me shkrim ku pala ankuese ndër të tjera thekson se, ka ngritur padi në Gjykatën Komunale Prishtinë në lidhje me shitjen e pa ligjshme të pronës së kërkuar lëndore nga personat e tretë, e cila gjykatë kishte lëshuar aktgjykimin në favor të saj dhe bashkëpronareve të tjerë si në Fletën Poseduese.
 - Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, lidhur me lëndën me numrin P.br. 538/02, më 23 Mars 2006 , i plotfuqishëm prej 07 Tetor 2008, të iniciuar nga palët ankuese dhe O. V., me të cilin ishin anuluar dy kontrata të shitblerjes të pronës lëndore, nr. ..., dhe nr. ..., të dt. 22.06.2001. Sipas këtij aktgjykimi shitblerja ishte bërë në bazë të autorizimeve të falsifikuara në emër të palëve ankuese, andaj shitësit ishin obliguar tua kthenin në pronësi pronën lëndore bashkëpronareve ligjore.
 - Kontratën e shitblerjes nr...., dt.22.06.2001, të lidhur në mes të O. V. shitëse dhe N. S. ,blerës lidhur me shitjen e pjesës ideale të saj të pronës lëndore.
4. Dokumentet e lartpërmendur të paraqitura nga pala ankuese në AKP, nga sekretaria e këtij organi ishin verifikuar pozitivisht.
5. Për pronën e njëjtë lëndore, ngastrat kadastrale nr. prej numër ... e gjer ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.78.45 ha, kërkesa teknikisht konkurruese në AKP, kishte paraqitur O. M. V., për secilën ngastër veç e veç, të cilat kërkesa në AKP ishin regjistruar në emër të saj me numrat, KPA00951, KPA41519, KPA41520, KPA41521, KPA41522, KPA41523, KPA41524, KPA41525, KPA41526, KPA41527 dhe KPA41528. Ajo po ashtu kërkon ri posedimin e pronave në të cilat ishte bashkëpronare me 2/6 pjesë ideale, së bashku me bashkëpronarët e tjerë. E njëjta ka paraqitur dokumente të njëjta të pronësisë si dhe Aktgjykimin nr. P.538/02, me të cilin ishin anuluar kontratat e shitblerjes lidhur me tjetërsimin e pronës lëndore për mes shitjes në mënyrë të kundërligjshme nga personat e tretë.

6. AKP kishte bërë njoftimin e kërkesës KPA00950, për pronën lëndore të kërkuar, me datë 16 Gusht 2008 për mes GSP kordinatave, dhe ortofotove nga kopja e planit. Me datë 19 korrik 2010 gjatë notifikimit fizik prona është gjet tokë e pa punuar, një pjesë rrugë, në këtë pronë ishte e vendosur një pikë shitëse e gazit. Prona ishte gjetur e zënë nga R. U., (në tekstin e mëtejme: Pala përgjegjëse në ankesë). I njëjti pretendon të drejtë ligjore mbi pronën lëndore, e nënshkruan njoftimin e pjesëmarrjes dhe merr pjesë në procedurën e zhvilluar në shkallën e parë.
7. Më 17 gusht 2010 në AKP, pala përgjegjëse në ankesë kishte dorëzuar përgjigje në kërkesë i cili kishte theksuar se, ngastrat lëndore i kishte blerë në mënyrë të ligjshme prej Rr. S. dhe N. S., e të cilët gjoja pronën lëndore e kanë blerë nga bashkëpronaret e cekura dhe se tani ky është pronar.
8. Së bashku me Përgjigjen, Pala përgjegjëse në ankesë, (tutje PP), kishte dorëzuar në AKP *inter alia*:
- Kopjen e Planit nr. ..., të datës 12 nëntor 2003, sipas së cilës PP paraqitet si bartës i të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar;
 - Kopjen e Fletës Poseduese nr. ..., të datës 12 nëntor 2003, sipas së cilës PP në ankesë paraqitet si bartës i të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar;
 - Kontratën nr. ..., mbi blerjen e patundshmërisë, të lidhur më 21 mars 2003 në mes të B. B. si shitës dhe PP si blerës, sipas së cilës shitësi i shet pjesën ideale të tij me 1/15, por që nuk ka të bëjë me pronën lëndore të kërkuar nga pala ankuese, andaj sekretaria nuk e ka parë të arsyeshme të bëjë verifikimin e kësaj kontrate;
 - Kontratën e shitblerjes nr. regj. ...02, të dt. 29 janar 2002, nuk ka të bëjë me pronën lëndore.
 - Kontratën e shitblerjes ..., të dt. 22 qershor 2001, të bërë në mes të O. V., (palë kërkuese sipas kërkesave të saj të cekura si më lartë), si shitëse dhe N. S. si blerës lidhur me shitjen e pjesës ideale të saj në parcelat e kërkuara.
 - Kontratën e shitblerjes nr. ..., lidhur në mes palëve ankuese si shitëse të pjesëve ideale të tyre të pronës lëndore, për mes gjoja te autorizuarit të tyre H. K. dhe Rr. S. blerës.
 - Planin kadastral i dt. 10 dhjetor 2003, i cili e paraqet PP, si bartës të drejtës pronësor me 1/1 pjesë ideale të pronës lëndore.
 - Kontratën nr. ... mbi blerjen e patundshmërisë, të lidhur më 31 janar 2002 në mes të Rr. S. dhe N. S. si shitës, dhe PP në ankesë si blerës.
9. Pas verifikimit të dokumenteve të palëve të cekura si më lartë, sekretaria pozitivisht i verifikon dokumentet e paraqitura nga palët ankuese. Po ashtu sekretaria *ex officio* gjen se, sipas Aktgjykimit të formës së prerë P.nr. 538/02, të dt. 23 Mars 2006 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, dy kontratat e shitblerjes të paraqitura nga pala përgjegjëse dhe pala ankuese dhe ate nr. ..., e dt. 22.06.2001, dhe nr. ..., e dt. 22.06.2001, lidhur me pronën lëndore ishin anuluar, sepse ishin të lidhura në bazë të

autorizimit të falsifikuar nga H. K. në emër të shitëseve, dhe blerësit e pohuar- të paditurit, ishin obliguar tua kthejnë pronën lëndore, pronareve ligjore G. B., Mirjana B. dhe O. V. si paditëse.

10. Më 7 Dhjetor 2011, KKPK me vendimin e vet grupor KPCC/D/A/135/2011, (paragrafët 11-42), që aplikohet për kërkesën lëndore KPA00950, të G. B., dhe pronën lëndore ngastrat kad. ..., në sipërfaqe prej 0.78.45ha, e kishte hedhur poshtë kërkesën e saj. Arsyetimi jepej në paragrafin 42 të këtij vendimi grupor (i cili nuk ishte adekuat për mënyrën e vendosjes së kërkesës KPA00950), sipas gjendjes faktike dhe juridike në shkresa të lëndës. Gjer sa në paragrafët 43 dhe 44 jepeshin arsyet për lëndët dhe kërkesat konkrete, sipas numrave të cekur si më lartë të kërkueseve, G. B., dhe O. V., ku ndër të tjera theksohej se; ato e kontestojnë shitjen e pronës lëndore, sepse prona e tyre ishte shitur nga personi i pa njohur për mes të një autorizimi të falsifikuar. Komisioni vëren se për këtë çështje sipas padisë së tyre çështja e njëjtë ishte vendosur më herët me aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës të dt. 23 mars 2006, i cili ishte bërë i plotfuqishëm më 07 tetor 2008, me të cilin ishin anuluar shitblerjet e pronës lëndore dhe u ishte konfirmuar e drejta pronësore kërkueseve. Kështu që pasi vendimi i gjykatës komunale ka të bëjë me të njëjtën lëndë si me kërkesat e paraqitura të kërkueseve, kjo përbën një çështje *res judicata*, andaj kërkesa duhet të hedhet poshtë.
11. Me datë 22 maj 2012, vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese G. B., ndërsa palës përgjegjëse R. U. me datë 20 prill 2012. Kundër këtij Vendimi palët ankuese nuk kishin ushtruar ankesë në afatin e paraparë ligjor.
12. KKPK me datë 29.09.2017 kishte nxjerrë vendimin tjetër individual nr. KPCC/D/A/135/2011, lidhur me kërkesën KPA00950, në emër të G. B., me të cilin e kishte bërë korrigjimin e vendimit të saj të më parshëm grupor KPCC/D/A/135/2011, të dt.12.07.2011. Në paragraf 4, të këtij vendimi theksohet se, për veç paragrafëve të tjerë përkatës në vendimin grupor, paragrafët 11, 43 dhe 44, aplikohen në mënyrë specifike për kërkesën”.
13. Me datë 31.10.2017, vendimi i korrektuar i dt. 29.09.2017, i ishte dorëzuar palës ankuese G. B., e njëjta me datë 22.11.2017, ka paraqitur ankesë në emër të saj, dhe sipas autorizimit në emër të M. B..
14. Me datë 12.10.2017, vendimi i njëjtë i është dorëzuar PP, R. U.a, ndërsa me datë 04.10.2017 Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Pretendimet e palëve;

15. **Palët ankuese** vendimin e ankimuar e atakojnë për shkak të; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, në arsyetim pasi i cekin kërkesat e ushtruara në AKP, të cekura si më lartë ndër të tjera theksojnë se; vendimi i ankimuar ka mangësi dhe është jo i plotë sepse në këtë çështje nuk kemi

- situatë *res judicata*, sepse nuk janë palët e njëjta dhe objekti i kontestit nuk është i njëjtë, sepse palë përgjegjëse tani paraqitet R. U., si uzurpues i pa ligjshëm i pronës së kërkuar, gjer sa palë të paditur në gjykatë komunale ishin persona të tjerë, andaj nuk është dashtë që kërkesa e tyre nga KKPK të hedhet poshtë. Se i posedojnë dokumentet valide për pronën lëndore nga të cilat dëshmohet se është e tyre dhe se të njëjtën e kanë humbur si pasojë e rrethanave të viteve 1998/99. Po ashtu sqarojnë se gjykata supreme sipas ankesave të bashkëpronares O. V., me datë 25 Nëntor 2015, ka nxjerr aktgjykimin GSK-KPA-A-067/2014, me të cilin janë aprovuar ankesat e saj, është anuluar vendimi KPCC/D/A/135/2011 i dt. 07 Dhjetor 2011, dhe asaj i është vërtetuar e drejta pronësore me 2/6 pjesë ideale, në pronën e njëjtë lëndore.
16. Në fund propozojnë që gjykata supreme me aprovimin e ankesës së tyre të bie vendim me të cilin të vërtetohet se u takon e drejta në pronën lëndore, e cila është lëndë e kërkesave KPA00950, KPA41519, KPA41520, KPA41521, KPA41522, KPA41523, KPA41524, KPA41525, KPA41526, KPA41527 dhe KPA41528.
 17. Ankesa e Palëve ankuese i ishte dorëzuar palës përgjegjëse R. U. me datë 28 maj 2018, i njëjti me datë 26 qershor 2018 ka paraqitur përgjigje në Ankesë.
 18. Po ashtu ankesa e palëve ankuese nga AKP, sipas evidencës në shkresa të lëndës i është dërguar O. V. me datë 23 shkurt 2018, në shkresa të lëndës nuk ka prova se e njëjta ka paraqitur përgjigje në ankesë në afatin e paraparë ligjor.
 19. **Pala përgjegjëse** vendimin e KKPK-së me të cilin është hedhë kërkesa e palës ankuese e vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj, ndërsa e kundërshton ankesën e palëve ankuese si jo të afatshme, dhe të pa bazuar në prova dhe fakte, se mbi çfarë baze e kërkojnë të drejtën e tyre pronësore, andaj propozon që ankesa e tyre të refuzohet në tërësi se e pa bazuar.
- Bashkimi i lëndëve sipas ankesës;**
20. Neni 13.4 i Rreg. se UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, mund të vendos mbi bashkimin apo shkrirjen e kërkesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i lejon Komisionit të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr vendime aty ku ka çështje të njëjta ligjore si dhe të provave.
 21. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Civile, të zbatueshme në procedurë para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme, në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, përkatësisht dispozitat e nenit 408.1, dhe 193 të Ligjit nr. 03/L006, të Procedurës Kontestimore, ofrojnë mundësinë e bashkimit të kërkesave përmes një aktvendimi, nëse kjo do të siguronte efikasitetin e gjykatës, zvogëlimin e kohëzgjatjes dhe shpenzimeve të procedurës.

22. Në tekstin e ankesës së përbashkët të paraqitur nga palët ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndëve ndaj të cilave janë paraqitur ankesat, faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë saktësisht të njëjta në të gjitha lëndët. Ankesa është e bazuar në deklaratë të njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë, e po ashtu prona lëndore është bashkëpronësi e palëve ankuese si dhe palës tjetër kërkuese sipas lëndëve të saj O. V.. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë, prandaj, ankesa e regjistruar me numrat GSK-KPA-A-001/2017, në emër të palës ankuese G. B., sipas lëndës KPA00950, dhe ankesa nga numri GSK-KPA-A-002/2018 deri në numër, GSK-KPA-010/2018, sipas kërkesave të paraqitura në AKP nga O. V. dhe lëndëve të formuara, në AKP, me numra; KPA41519, KPA41520, KPA41521, KPA41522, KPA41523, KPA41524, KPA41525, KPA41526, KPA41527 dhe KPA41528, bashkohen në një lëndë të vetme, e cila mban numrin GSK-KPA-A-001/2018.

Pranueshmëria e ankesës,

23. Ankesa e ushtruar nga G. B. është e afatshme, është paraqitur brenda 30 ditëve, pas pranimit të Vendimit të përmirësuar të KKPK-së, ashtu si parashihet me nenin 12.1 të Rreg. së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe ate komerciale e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

24. Po ashtu ankesa e saj është e lejueshme si në kuptim të nenit 165 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (ligji Nr. 03/L-006), i zbatueshëm në procedurën e vendosjes së kolegjit të gjykatës supreme, sepse me vendimin e korrigjuar të KKPK-së nr. KPCC/D/A/135/2011, të datës 07/12/2017, është bërë ndryshimi i paragrafëve të vendimit grupor nr. KPCC/D/A/135/2011, të dt. 07.12.2011, ku janë ndryshuar paragrafët për kërkesat individuale të palës ankuese G. B. dhe O. V., nga paragrafi 42, në paragrafët 43-44, që i përmbajnë arsyet lidhur me mënyrën e vendosjes së kërkesave të tyre, si në dispozitiv të vendimit të KKPK-së, e jo nga ato të dhëna në parag.42, që e bënin të pa qartë ate, dispozitivi rezultonte në kundërshtim me arsyetimin e tij, andaj për këto arsye ankesa është e pranueshme, sepse palës i është dërguar kopja e korrigjuar e vendimit me të cilën është zëvendësuar origjinali i vendimit të më parme i cili është shpallë i pa vlefshëm, e po ashtu ankesa ka të bëjë tani me pjesën e korrigjuar, si në paragrafët 43-44 të vendimit grupor, KPCC/D/A/135/2011, të dt. 07.12.2011, ashtu si parashihet me nenin 165, par.3, të LPK-së, (shih shkresat-sqarimet e AKP-së, dërguar palëve, faqe 248-252, në shkresat e lëndës).

25. Ankesa e ushtruar nga M. B. për mes të autorizuarës-ankueses G. B. është e pa lejueshme, sepse është paraqitur nga personi që nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së.

26. Neni 10.2, i ligjit të njëjtë parasheh se *“Çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës dhe/ose ndonjë person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë ... , me kusht që ai person e informon Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij/saj që të merr pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive [...]”*.
27. Vetëm pala që merr pjesë në procedurën në shkallën e parë në AKP, ka të drejtë që të paraqet ankesë kundër Vendimit të KKPK-së. Në rastin në fjalë, Gjykata Supreme vlerëson se pala ankuese ka qenë në dijeni për procedurën që zhvillohej në lëndët sipas kërkesave të cekura si më lartë të paraqitura nga G. B.dhe O. V. sepse e njëjta në theksimet e saj nuk e konteston mënyrën e njoftimit për pronën lëndore.
28. Prandaj ankesa e M. B. , hedhet poshtë në përputhje me nenin 12.1 dhe 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1, nën-paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
29. Po ashtu ankesa e Gordana Brkic, paraqitur kundër Vendimit KPCC/D/A/135/2011, të dt. 07.12.2011, lidhur me lëndët e regjistruara në AKP sipas kërkesave të O. V., KPA41519, KPA41520, KPA41521, KPA41522, KPA41523, KPA41524, KPA41525, KPA41526, KPA41527 dhe KPA41528, lëndët e formuara në gjykatë supreme me numër prej GSK-KPA-A-002/2018, deri GSK-KPA-A-10.2018, hedhen poshtë si e pa lejueshme, sepse nuk ishte palë në këto lëndë,(sipas vendimit individual të KKPK-së, Gordana kishte ushtruar kërkesa individuale në emër të saj), dhe po ashtu lidhur me këto lëndë është vendosur, meritorisht me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Supreme, nr.GSK-KPA-A-67/2014, të dt. 25. 11. 2015, me të cilin janë aprovuar ankesat e ankueses O. V., ndërsa është ndryshuar vendimi i KKPK-së, nr. KPCC/D/A/135/2011, i dt.07/12/2011, ashtu që asaj i është njohur e drejta në pronësi dhe ri posedim të pronës së njëjtë të kërkuar, në ngastrat kadastrale nga numri 2954/1, deri në 2954/10, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.78. 45ha., si bashkëpronare me 2/6 pjesë ideale, sipas kërkesave të saj, të cekura si më lartë.
30. Megjithatë pasi çështja lidhur me pronën lëndore sipas ankesave të palëve ankuese G. B. dhe O. V., është vendosur në favor të tyre ndërsa edhe M. B. është bashkëpronare me 1/6, pjesë ideale, me mënyrën e vendosjes nuk i cënohet asnjë e drejtë në pjesën ideale të saj në pronën lëndore edhe pse nuk ka qen palë në procedurën e zhvilluar në AKP.

Meritat,

Arsyetimi ligjor;

31. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave nga dosja e lëndës, vendimit të kundërshtuar, pretendimeve të palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë gjen se, ankesa e ushtruar nga G. B., është e bazuar vetëm sa i përket lëndës së saj të regjistruar në AKP me numër KPA00950.

32. Kolegji i gjykatës supreme vlerëson se në bazë të parimit *res judicata*, një lëndë nuk shqyrtohet nga gjykata kur e njëjta çështje lëndore, me të njëjtat palë pjesëmarrëse në procedurë, është vendosur më herët në një procedurë gjyqësore nga gjykata e njëjtë apo nga një gjykatë tjetër. Në rastin aktual nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë pasi që as çështja në shqyrtim e vendosur nga Gjykata Komunale në Prishtinë dhe as palët pjesëmarrëse nuk ishin të njëjta në të dy procedurat në atë gjyqësore dhe tani në AKP.
33. Andaj sipas kolegjit të gjykatës supreme, KKPK nuk ka vendosur ligjërisht drejtë me hedhjen poshtë të kërkesës së palës ankuese duke iu referuar bazës për nxjerrjen e vendimit se, lënda përbënë çështje të gjykuar (*res judicata*), si çështje e njëjtë e vendosur nga Gjykata Komunale.
34. Paraqitëse të kërkesës (paditëse) në Gjykatën Komunale ishin: O. V., G. B. dhe M. B.. Ato kanë përmendur si palë përgjegjëse në kërkesë (si të paditur) H.K. i cili ishte bartës i autorizimit të falsifikuar Ov. Nr. 361/2001, të dt. 11.06.2001 dhe Rr. S. e N. S. si blerës të pronës lëndore. Lënda e procedurës gjyqësore ishte anulimi i dy kontratave të shitblerjes të pronës së paluajtshme lëndore, sipas të cilave palët e paditura gjoja e kishin blerë nga paraqitëset e kërkesës, tani palët ankuese. Gjykata kishte marr aktgjykimin ndaj personave të fundit dhe i kishte anuluar kontratat e përmendura (të vërtetuara nga Gjykata Komunale me numrat: Ov. br. ..., dhe Ov. br. ... më 22 qershor 2001), dhe kishte urdhëruar ri-posedimin e pronës, pra tu kthehej prona lëndore nga palët e paditura tek paraqitëset e kërkesës-paditëset si pronare ligjore.
35. Ndërkaq, në rastin aktual, si paraqitëse e kërkesës në AKP shfaqen G. B. dhe O. V. sipas kërkesave të cekura të tyre si në paragraf 1 dhe 5 të këtij aktgjykimi, të cilat kërkojnë kthimin e posedimit të pronës lëndore të cilën theksojnë se e kanë humbur si pasojë e luftës në Kosovë të viteve 1998/99. Kërkesat ishin kundërshtuar nga R. U. i cili kishte marrë pjesë në procedurën para KKPK, si palë përgjegjëse në AKP, e i cili nuk ishte palë në procedurën e zhvilluar gjyqësore. I njëjti i paraqet arsyet e tij duke deklaruar dhe ofruar dokumente të ndryshme se ai e kishte blerë pronën e kërkuar mbi bazën e kontratave të shitblerjes të cekura, *inter alia* kishte përmendur kontratën e blerjes të lidhur më 31 janar 2002, dhe të vërtetuar në gjykatë, me numrin 453/2002.
36. Nga kjo gjendje kur bëhet krahasimi i elementeve të përmendura, çështja e vendosjes sipas objektit të saj dhe palët pjesëmarrëse në gjykatë të rregullt dhe sipas kërkesave në AKP, nuk mund të konkludohet se palët dhe çështja e shqyrtimit është e njëjtë edhe pse çështja lëndore është e ndërlidhur. Sipas Gjykatës Supreme kërkesa e palës ankuese duhet të shqyrtohet për sa i takon meritave. Andaj Gjykata Supreme konsideron se vendimi i KKPK-së, ishte i padrejtë dhe duhej ndryshuar.
37. Duke iu referuar përmbajtjes së kërkesës dhe duke marrë parasysh faktin se kontratat e shitblerjes ov.br.3332/2001, e lidhur në mes të ankueseve si shitëse dhe blerësit Rr.

- S. dhe kontrata me nr. 3333/2001, të dt. 22.06.2001, e lidhur në mes të kërkueses tjetër O. V. si shitëse dhe N. S., ishin shpallur me një aktgjykim të plotfuqishëm si të pavlefshme, gjykata supreme nga këto fakte vlerëson se bartja e të drejtave pronësore e pronës lëndore tani nga shitësit Rr. S. dhe N. S. tek pala përgjegjëse në ankesë R. U.mbi bazën e kontratës nr. vr...., të lidhur më vonë më 31 janar 2002, nuk kishte mundur të ndodhte. Me fjalë të tjera, dispozitat e kontratës së shitblerjes të lidhur në mes të shitësve të lartë cekur, dhe palës përgjegjëse në ankesë si blerës, nuk kanë mundur të kenë efekt ligjor, sepse shitësit asnjëherë nuk e kishin blerë pronën lëndore në mënyrë të ligjshme nga palët kërkuese në AKP tani palë ankuese. Rrjedhimisht në fazën e tanishme R. U., nuk mund të konsiderohet si pronar i ligjshëm i pronës së kërkuar, sepse kontratat e shitblerjes ishin anuluar me aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës Komunale Prishtinë, P.br .538/02, të dt. 23 Mars 2006 , i plotfuqishëm prej 07 Tetor 2008 .
38. Për gjithë arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme vlerëson se pala ankuese G. B. ka paraqitur kërkesë të kompletuar në AKP dhe si e tillë është e pranueshme dhe bie në juridiksionin e AKP-së dhe gjykatës supreme sipas kohës së humbjes së posedimit të pronës lëndore siç e cek në kërkesë 15 qershor 1999, andaj gjykata supreme ankesën e saj e shqyrton dhe vendosë në mënyrë meritore.
39. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, KKPK-ja, dhe në nivel të instancës së dytë Gjykata Supreme ka kompetencë për të zgjidhur kërkesat në lidhje me konfliktet pronësore rreth pronës së paluajtshme, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën komerciale, që përfshijnë rrethanat që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë ose ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, kur paraqitësi i kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tij pronësore.
40. Nga shkresat e lëndës dhe në bazë të dëshmive pronësore të paraqitura nga pala ankuese në AKP, të cekura si në paragrafin 3, të këtij aktgjykimi, dëshmohet se ajo e ka vërtetuar pronësinë si bashkëpronare me 1/6, pjesë ideale të pronës së kërkuar dhe se e njëjta e ka humbur posedimin e saj për shkak të konfliktit të ndodhur në vitet 1998-1999, kështu që ajo e ka të drejtën e ri-posedimit të pronës lëndore. Andaj gjykata supreme e urdhëron çdo person i cili në mënyrë të pa ligjshme e ka uzurpuar ta liroj brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Mosveprimi në përputhje me këtë urdhër shpie në dëbimin nga prona lëndore.
41. Gjykata Supreme vlerëson se dokumentet e tjera të dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë R. U., janë të pavlefshme për lëshimin e aktgjykimit të plotfuqishëm në favor të tij sepse, nuk i referohen pjesës ideale të pronës së kërkuar nga ankueset si bashkëpronare, por paraqiten si kontrata të shitblerjes ku pronarë të ngastrave-pronës së kërkuar, paraqiten persona të tjerë sipas pjesës ideale të tyre të pronësisë. Për këto

arsye Gjykata Supreme nuk e diskuton vlefshmërinë ose efektin juridik eventual edhe të dokumenteve të tjera të paraqitura nga ai, sa i përket pjesës ideale të pronësisë në pronën lëndore të palës ankuese.

42. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, dhe nenin 195 paragrafi 1(e) të LPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

43. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-001-2018, me datë 23 Shtator 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani